L I G J
Nr.7979, datë 26.7.1995

PËR FONDET E INVESTIMEVE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj rregullon mënyrën e formimit, veprimtarinë e fondeve të investimeve, mbrojtjen e investitorëve dhe mbikëqyrjen shtetërore të fondeve të investimeve.

Neni 2

Përveçse kur përcaktohen ndryshe, në këtë ligj termat e mëposhtme do të nënkuptojnë:

2.1. Me "fond investimesh" nënkuptohet çdo person juridik privat që, duke akumuluar burimet financiare të personave fizikë a juridikë (letrat me vlerë të privatizimit, kesh),

- emeton vetëm aksionet e tij në këmbim të tyre;
- investon, riinvestoni, zotëron ose tregton letrat me vlerë.

2.2 Me "aksion" kuptojmë pjesën e përcaktuar të pronësisë në kapitalin e fondit të investimeve. Pronari i aksionit ka të drejtë të përfitojë proporcionalisht pjesën e tij në fitimin e shoqërisë tregtare dhe të marrë pjesë në drejtimin e kësaj shoqërie sipas kontratës së themelimit, e cila gjithashtu përcakton mënyrën e transferimit të aksioneve (kalimi i pronësisë).

2.3 Me "autoritet rregullues" do të kuptojmë Ministrinë e Financave.

2.4 Me "administrator" në fondin e investimeve do të kuptojmë çdo subjekt që është licencuar si administrator në përputhje me kreun VIII të këtij ligji.

2.5 Me "themelues" të fondit të investimeve do të kuptojmë subjektet që derdhin pjesën përkatëse në kapitalin themeltar të fondit të investimeve, përpara se të kryhet regjistrimi i tij.

2.6 Me "depozitues" për fondin e investimeve do të kuptojmë çdo subjekt që është licencuar si depozitues në përputhje me kreun IX të këtij ligji dhe që nuk është filial, degë, agjenci ose përfaqësues i fondit.

2.7 Me "ekspertë kontabël të pavarur" të fondit të investimeve do të kuptojmë çdo subjekt të licencuar që vepron si i tillë në përputhje me seksionin 7 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe që nuk është filial, degë, agjenci ose përfaqësues i fondit.

2.8 Me "person i interesuar" në lidhje me fondin e investimeve do të kuptojmë administratorin, anëtarët e këshillit të mbikëqyrjes, nëpunësit e administratorit dhe të fondit të investimeve.

2.9 Me "statut" do të kuptojmë aktin që përcakton formën, kohëzgjatjen, emërtimin, objektin, shumën e kapitalit themeltar dhe drejtimin e fondit të investimeve, i cili duhet t'i përmbahet modelit të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

2.10 Me "marrëveshje administrimi" do të kuptojmë marrëveshjen e përfunduar ndërmjet fondit të investimeve dhe administratorit, që duhet t'i përmbahet modelit të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

2.11 Me “marrëveshje depozitë” do të kuptojmë marrëveshjen e përfunduar ndërmjet fondit të investimeve dhe depozituesit, e cila duhet t’i përmbahet modelit të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

2.12 Me “kontroll” do të kuptojmë të drejtën për të ushtruar inspektimin sistematik të llogarive kontabël, duke përfshirë analizat, testet dhe konfirmimet për drejtimin ose politikat e fondit të investimeve, duke përfshirë hetimin dhe ekzaminimin e transaksioneve financiare.

2.13 “Vlerë neto të aseteve” do të kuptojmë vlerën në lekë, të barabartë me diferencën neto midis aseteve dhe detyrimeve të përgjithshme të fondit.

2.14 Me “vlerë neto proporcionale të aseteve” të një aksioni të një fondi investimi në një datë të dhënë do të kuptojmë raportin e vlerës totale neto të aseteve të fondit të investimit në atë ditë me numrin total të aksioneve në fondin e investimit të emetuar dhe të papaguara në ditën e dhënë.

II. FORMA LIGJORE DHE THEMELUESIT E FONDIT TË INVESTIMEVE

Neni 3

3.1 Fondi i investimeve themelohet dhe organizohet si shoqëri anonime në përputhje me legjislacionin shqiptar.

3.2 Statuti i fondit të investimeve duhet të jetë në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe sipas modelit të statutit për fondet e investimeve, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

3.3 Emërtimi i fondit të investimeve duhet të përfshijë fjalët “fondi i investimeve”.

3.4 Asnjë subjekt tjetër nuk mund të përdorë në emrin e tij fjalët “fond investimi” ose fjalë të tjera në kuptim të njëjtë.

Neni 4

4.1 Nuk ka kufizime përsa i përket numrit minimal të themeluesve të një fondi investimesh.

4.2 Çdo subjekt i regjistruar, me vendbanim në Republikën e Shqipërisë, përveç subjekteve të përcaktuara në nenin 4.3 të këtij ligji, mund të jetë themelues i fondit të investimeve. Subjektet e huaja dhe shoqëritë e përbashkëta mund të veprojnë si themelues të fondeve të investimeve vetëm në bashkëpunim me persona fizikë e juridikë shqiptarë me kapital tërësisht shqiptar dhe që marrin përsipër të paktën 50 për qind të kapitalit fillestar të depozitës së fondit sipas këtij ligji.

4.3 Përjashtohen bankat nga veprimtaria e themelimit të një fondi investimesh.

4.4 Themeluesit e një fondi investimesh do të jenë përgjegjës për të gjitha shpenzimet që burojnë nga dhe në emër të fondit të investimeve, përpara regjistrimit të këtij të fundit në regjistrin tregtar.

4.5 Themeluesit e një fondi investimesh nuk do të kenë të drejtën e privilegjeve, të cilat nuk i gëzojnë as aksionarët e tjerë të fondit të investimeve. Themeluesit nuk do të kenë të drejtën të marrin aksione ose pagesa për shërbimet që kanë kryer gjatë themelimit të fondit të investimeve. Për themeluesit e fondit të investimeve nuk është e nevojshme të zotërojnë përqindje minimum ose numër aksionesh të fondit të investimeve.

4.6 Subjektet e licencuara, si tregtarë letrash me vlerë, asgjentë të bursës e shoqëri sigurimi, mund të veprojnë si themelues të një fondi investimesh në përputhje me nenet e këtij ligji.

III. LICENCIMI DHE FORMIMI I FONDIT TË INVESTIMEVE

Neni 5

Fondi i investimeve nuk do të regjistrohet në regjistrin tregtar para se të ketë marrë një licencë të përkohshme nga autoritetet rregulluese.

5.1 Përpara se t'i nënshtrohet kërkesës për licencë të përkohshme për fondin e investimeve, themeluesit e tij duhet:

- Të paraqesin statutin në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe sipas modelit të statutit për fondet e investimeve, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

- Të përgatitin një projekt të marrëveshjes së administrimit për fondin e investimeve, sipas modelit të marrëveshjes së administrimit për fondin e investimeve, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

- Të përgatitin një projekt të marrëveshjes së depozitës për fondin e investimeve, sipas modelit të marrëveshjes së depozitës për fondin e investimeve, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

- Të depozitojnë jo më pak se ekuivalentin në lekë të 20 000 USD, që do të përfaqësojë kapitalin themelor, të mbajtur nga depozituesi i fondit në kesh.

Kjo depozitë duhet të kreditohet si kapital i derdhur i themeluesve dhe si kapital fillestar i aksioneve të fondit.

5.2.Autoriteti rregullues duhet të japë ose të refuzojë licencën e përkohshme për një fond investimi brenda 15 ditëve nga marrja e dokumenteve të mëposhtme:

1. Kërkesë për licencë të nënshkruar nga të gjithë themeluesit e fondit të investimeve.

2. Statutin e nënshkruar nga të gjithë themeluesit e fondit të investimeve.

3. Projektmarrëveshjen e administrimit për fondin e investimeve të nënshkruar nga administratori i licencuar i cili ka pranuar të veprojë si administrator i fondit të investimeve.

4. Projektmarrëveshjen e depozitës të nënshkruar nga depozituesi i licencuar, i cili ka pranuar të veprojë si depozitues për fondin e investimeve.

5. Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës për depozitën nga themeluesit në zbatim të nenit 5.1 të këtij ligji.

6. "Curiculum vitae" dhe përshkrim të përvojës profesionale për secilin nga themeluesit, drejtuesit ekzekutivë të fondit të investimeve.

7. Informacione të tjera të këtij lloji të kërkuara nga autoriteti rregullues.

8. Licenca e përkohshme do të jetë e vlefshme deri në dy muaj pas datës së miratimit të saj.

5.3 Përpara paraqitjes së kërkesës për licencë përfundimtare dhe dhënies së saj për fondin e investimeve, themeluesit e fondit duhet:

a) Të regjistrojnë fondin e investimeve si shoqëri anonime sipas dispozitave në fuqi.

b) Të depozitojnë marrëveshjen e administrimit dhe marrëveshjen e depozitës për fondin e investimeve.

c) Të përgatitin një plan për ofertën publike të aksioneve të fondit të investimeve dhe ta paraqesin këtë plan për regjistrim në përputhje me aktet ligjore e nënligjore dhe sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

5.4 Përveç parashikimeve të nenit 5.5, autoriteti rregullues do të nxjerrë licencën përfundimtare të fondit të investimeve brenda 20 ditëve nga marrja e dokumenteve të mëposhtme:

- Një kërkesë përfundimtare të firmosur nga të gjithë themeluesit e fondit të investimeve.

- Dokumentin që vërteton regjistrimin e fondit të investimeve në regjistrin tregtar si shoqëri anonime.

- Statutin e regjistruar të fondit të investimeve.

- Planin e ofertës publike të aksioneve të fondit të investimeve, të shoqëruar nga kërkesa për regjistrimin e tij në përputhje me aktet ligjore e nënligjore sipas nenit 5.3, pika c.

- Marrëveshjet e përfunduara ndërmjet fondit të investimeve dhe administratorit të licencuar si dhe fondit të investimeve dhe një depozituesi të licencuar.

- “Curriuculum vitae” dhe përshkrim të përvojës profesionale për secilin nga themeluesit, drejtuesit ekzekutivë dhe anëtarët e këshillit të mbikëqyrjes të fondit të investimeve.

- Informacione të tjera të këtij lloji të kërkuara nga autoriteti rregullues.

Licenca përfundimtare nuk do t’u jepet subjekteve që nuk kanë marrë më parë licencën e përkohshme të fondit të investimeve.

5.5 Autoriteti rregullues duhet të refuzojë të japë licencën vetëm në rast se:

- Një fond investimi nuk plotëson dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar sipas nenit 5.4.

- Ky dokumentacion përmban materiale që çojnë në vlerësime të gabuara, shtrembëron faktet juridike ose nuk i paraqet qartë këto fakte.

- Fondi i investimeve ose themeluesit e tij nuk kanë vepruar në përputhje të plotë me termat e këtij ligji.

IV. KAPITALI AKSIONAR NË FONDIN E INVESTIMEVE

Neni 6

6.1 Kapitali i një fondi investimesh do të formohet ekskluzivisht nga emetimi dhe vënia në qarkullim e një klase të vetme titujsh të regjistruar. Çdo aksion i kësaj klase, pa marrë parasysh seritë, do të ketë një votë në asamblenë e aksionarëve dhe do të ndahet në mënyrë të barabartë pronësia dhe të ardhurat e fondit të investimeve.

Fondi i investimeve nuk mund të emetojë dhe të nxjerrë në qarkullim tipa të tjerë titujsh, përveç aksioneve të tij.

6.2 Aksionet në një fond investimi mund të këmbehen vetëm në këmbim të kontributeve në bono privatizimi. Kontributi në kesh mund të pranohet vetëm pasi të jenë përcaktuar në masën 100 për qind mbajtësit e aksioneve të një fondi investimesh.

6.3 E gjithë sasia kesh dhe bonot e privatizimit të kontribuara në një fond investimi do të paguhen drejtpërdrejt në llogarinë e fondit të mbajtur nga depozituesi i tij. Kontributet kapitale duhet të paguhen plotësisht.

6.4 Të gjitha aksionet në një fond investimi duhet të jenë të regjistruara dhe lirisht të transferueshme.

a) Kur një fond investimesh nuk është regjistruar në një bursë të licencuar të letrave me vlerë, transferuesi dhe marrësi i aksionit do të përfundojë një marrëveshje të nënshkruar për evidentimin e transferimit, një kopje të së cilës e dërgojnë në fondin e investimit. Fondi i investimeve, menjëherë pas kësaj, e regjistron këtë transferim brenda 10 ditëve në vijim.

b) Kur një fond investimesh është i regjistruar në një bursë të licencuar të letrave me vlerë, transferimi kryhet në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara në bursë.

6.5 Bankat nuk mund të jenë aksionarë në një fond investimesh.

V. OFERTA PUBLIKE E AKSIONEVE ME NJË FOND INVESTIMI

Neni 7

7.1. Fondi i investimeve duhet të publikojë planin e ofertës së aksioneve dhe t’i ofrojë ato për nënshkrim (firmë) në përputhje me këtë plan.

7.2 Aksionet në një fond investimi do të emetohen në seri. Periudha e nënshkrimit të aksioneve nuk do të zgjatë më shumë se 4 muaj. Në fund të nënshkrimit të serisë së aksioneve, një fond investimesh duhet të bëjë shënimet në statut dhe të regjistrojë në librin e shoqërisë rritjen e aksioneve të kapitalit të fondit të investimit që ka rezultuar nga pagimi i nënshkrimeve.

7.3 Fondi i investimeve duhet të regjistrojë një plan të veçantë për çdo seri të aksioneve të tij. Një seri aksionesh mund të ofrohet për nënshkrim vetëm një herë të vetme. Një fond

investimesh mund të nxjerrë në qarkullim një seri aksionesh, vetëm me miratimin e shumicës së votave të llogaritura në një mbledhje të thirrur të aksionarëve. Përpara thirrjes së mbledhjes së aksionarëve për të shqyrtuar vënien në qarkullim të serisë së aksioneve, këshilli mbikëqyrës i fondit të investimit duhet të paraqesë para aksionarëve të fondit të investimeve bilancin e fondit të investimeve, vlerën neto të aseteve dhe gjendjen e të ardhurave për tre muajt e fundit, të vlerësuara nga ekspertët kontabël të pavarur të fondit të investimeve.

7.4 Në rast pezullimi ose revokimi të planit, fondi i investimeve duhet të ndalojë menjëherë vazhdimin e çdo oferte të mëtejshme të aksioneve të tij, derisa një pezullim ose revokim i tillë të jetë anuluar ose të jetë bërë një regjistrim i ri.

7.5 Aksionet në një fond investimi duhet të emetohen me një çmim të barabartë me vlerën neto proporcionale të aseteve të aksioneve të fondit në datën e hapjes së periudhës së nënshkrimit për seritë në të cilat aksionet janë ofruar.

VI. E DREJTA E RIBLERJES SË AKSIONEVE NË FONDIN E INVESTIMEVE

Neni 8

8.1 Fondet e Investimeve nuk mund të nxjerrin në qarkullim aksione të riblershme.

VII. ORGANET DREJTUESE TË FONDIT TË INVESTIMEVE

Neni 9

9.1 Organi drejtues i një fondi investimesh do të jetë mbledhja e përgjithshme e aksionarëve (asambleja) dhe këshilli mbikëqyrës.

9.2 Organet drejtuese të një fondi investimesh do të kenë të drejtat dhe detyrat e parashikuara në statutin e fondit të investimeve dhe në ligjin që rregullon veprimtarinë e shoqërive anonime në Republikën e Shqipërisë.

VIII. ADMINISTRATORI I FONDIT TË INVESTIMEVE

Neni 10

10.1 Çdo fond investimesh duhet të emërojë një administrator të licencuar, me qëllim që të përmbushë detyrat e administratorit të përcaktuara në marrëveshjen e administrimit. Administratori duhet të jetë një subjekt jo i punësuar në fondin e investimeve. Autoriteti rregullues do të publikojë rregulla të veçanta që përcaktojnë mënyrën e dhënies e të revokimit të licencës për një administrator të fondit të investimeve. Një subjekt tjetër dhe degët e tij nuk mund të shërbejnë si administrator në më shumë se dy fonde investimesh.

10.2 Një shtesë ose ndryshim në marrëveshjen e administrimit bëhet vetëm me votimin pro të dy të tretave të aksionarëve të fondit të investimeve, edhe nëse ky ndryshim apo shtesë është në përputhje me ligjet në fuqi.

10.3 Administratori do të marrë shpërblim deri në 3 për qind të mesatares së vlerës neto të aseteve të fondit të investimeve gjatë vitit korrent. Mbledhja e përgjithshme e aksionarëve të fondit ka të drejtë t’i dhurojë administratorit një shpërblim vjetor të bazuar në përqindjen e fitimit neto të fondit gjatë vitit korrent.

Në marrëveshjen e administrimit duhet të jetë përcaktuar pjesa e shpenzimeve operative të fondit që do të përballohet nga administratori i tij. Për këtë qëllim administratori duhet të mbajë një rezervë në kesh.

10.4 Një administrator do të jetë përgjegjës përpara fondit të investimeve dhe aksionarëve

të tij, në përputhje me legjislacionin civil e penal të Republikës së Shqipërisë, për humbjet që i janë shkaktuar fondit të investimeve si pasojë e neglizhencës, mashtrimit, përvetësimit ose shkeljes së termave të këtij ligji a të marrëveshjes së administrimit, të kryera nga administratori, degët e tij ose anëtarët e këshillit të mbikëqyrjes.

IX. DEPOZITUESI

Neni 11

11.1 Çdo fond investimi duhet të emërojë një depozitues të licencuar për të përmbushur detyrat e depozituesit. Çdo ndryshim ose shtesë në marrëveshjen ndërmjet fondit të investimeve dhe depozituesit bëhet vetëm me votimin pro të dy të tretave të aksionareve të fondit të investimeve, edhe nëse ky ndryshim apo shtesë është sipas ligjeve në fuqi.

11.2. Depozituesi duhet të jetë një bankë ose institucion tjetër financiar i aftë të kryejë detyrat e depozituesit të përcaktuara në marrëveshjen e depozitës. Gjithë depozituesit duhet të jenë të licensuar si të tillë në përputhje me rregullat e parashikuara nga autoriteti rregullues.

11.3. Një depozitues nuk mund të përdorë asetet e një fondi investimesh në asnjë mënyrë tjetër, përveç asaj të autorizuar në përputhje me marrëveshjen e depozitës.

11.4. Depozituesi do të jetë përgjegjës përpara fondit të investimeve dhe aksionarëve të tij, në përputhje me legjislacionin civil e penal të Republikës së Shqipërisë, për humbjet që i janë shkaktuar fondit të investimeve si pasojë e neglizhencës, mashtrimit, përvetësimit ose shkeljes së termave të këtij ligji a të marrëveshjes së depozitës të kryera nga depozituesi, degët e tij ose anëtarët e këshillit të mbikëqyrjes.

X. EKSPERTËT KONTABËL TË PAVARUR

Neni 12

12.1. Çdo fond investimesh duhet të emërojë një ekspert kontabël për të kontrolluar librat dhe regjistrat e fondit të investimeve dhe drejtuesit e tij periodikisht.

12.2. Gjithë ekspertët kontabël duhet të jenë të licencuar në përputhje me rregullat e parashikuara nga autoriteti rregullues.

12.3. Eksperti kontabël përgatit një deklaratë me vërejtjet për saktësinë e raportit vjetor të fondit të investimeve, të përgatitur në përputhje me statutin. Kjo deklaratë publikohet dhe skedohet së bashku me raportin vjetor.

XI. KUFIZIMET

Neni 13

13.1. Një fond investimesh nuk do të kryejë veprimet e mëposhtme:

- Të investojë më shumë se 10 për qind të aseteve të tij neto në aksionet e një subjekti të vetëm.
- Të investojë në aksionet e emetuara nga fonde të tjera investimesh.
- Të investojë në çdo subjekt që zotëron më shumë se 5 për qind të aksioneve të fondit.
- Të pranojë të shesë aksione që nuk i zotëron.
- Të marrë para borxh ose kredi të çdo lloji.
- Të japë garanci ose premtime të çdo lloji.
- Të ketë pronësi ose interesa debitore te drejtuesi i tij dhe depozituesi i tij, eksperti kontabël i tij.

13.2. Një fond investimi nuk do të kryejë edhe këto veprime:

- Të zotërojë asete të tjera, përveçse në njësinë monetare të Shqipërisë, bono të privatizimit, aksione në shoqëritë aksionare.

- Të investojë në çdo shoqëri që nuk është e angazhuar në veprimtari tregtare në Shqipëri.

- Të tregtojë ose disponojë bono privatizimi në mënyra të tjera, përveçse në këmbim të aksioneve të emetuara si pasojë e privatizimit ose shndërrimit të ndërmarrjeve shtetërore.

- Të japë kredi ose hua.

- Të lidhë marrëveshje që nuk kanë të bëjnë me veprimtarinë e investimeve.

- Të pranojë bono privatizimi në këmbim të aksioneve të tij, në qoftë se vlera nominale e përgjithshme e bonove të pranuara nga fondi i investimeve dhe degët e tij do të ishte më e madhe se 10 për qind e vlerës nominale të përgjithshme të të gjitha bonove të privatizimit të emetuara në Shqipëri deri në atë kohë.

- Të angazhohet në veprimtari të tjera tregtare, përveçse në ato të investimeve, riinvestimeve dhe tregtimit të aksioneve.

- Të kryejë investime sipas ligjeve në fuqi, përveçse atyre të përcaktuara në këtë ligj.

XII. KONFLIKTET DHE PERSONAT E PALIGJSHËM

Neni 14

14.1. Mosmarrëveshjet ndërmjet themeluesve të një fondi investimesh dhe autoritetit rregullues do të zgjidhen në gjykatë.

14.2. Do të konsiderohet e paligjshme që të shërbejnë si të punësuar, si nëpunës ose anëtarë të këshillit mbikëqyrës të çdo fondi investimi, si dhe të veprojnë si drejtues, si ekspertë kontabël ose si depozitues të një fondi investimesh, subjektet e mëposhtme:

- Çdo subjekt i pakualifikuar sipas përcaktimeve të legjislacionit shqiptar.

- Çdo subjekt që është konsideruar nga autoriteti rregullues se ka shkelur plotësisht dhe me qëllim dispozitat e këtij ligji, si dhe akte ligjore e nënligjore.

- Çdo subjekt që është konsideruar nga autoriteti rregullues se ka bërë qëllimisht përcaktime që të çojnë në gjykime të gabuara në dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit rregullues në lidhje me kryerjen e regjistrimit të aksioneve ose dhënien e licencës për një fond investimesh drejtues ose depozitues.

14.3. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës dhe nëpunësit ekzekutivë të një fondi investimesh nuk do të jenë degë të depozituesit, drejtuesit ose ekspertit kontabël të këtij fondi.

14.4. Depozituesit dhe ekspertët kontabël të një fondi investimesh nuk do të jenë degë të këtij fondi .

14.5. Drejtuesi, depozituesi dhe eksperti kontabël të një fondi investimesh nuk do të jenë degë të njera-tjetrës.

14.6. Të gjithë personat e interesuar, të përcaktuar në nenin 2.8 të këtij ligji, duhet të bien në marrëveshje me fondin e investimeve, në mirëbesim e barazi, dhe veçanërisht duhet që:

- Secili nga personat e interesuar t'u bëjë të ditur aksionarëve të fondit çdo interes, pronësi, marrëveshje financiare ose marrëdhënie kontraktuese me ndonjë fond tjetër investimesh dhe duhet t'i ndërpresë ato me kërkesën e një shumice të aksionarëve.

- Në çdo transaksion, në të cilin një shoqëri që është palë zotërohet me të paktën 10 për qind nga fondi i investimeve, personat e interesuar nuk duhet të këshillojnë një palë të tretë pa miratimin e shumicës së aksionarëve.

- Çdo kontratë ndërmjet një personi të interesuar dhe një shoqërie, në të cilën fondi i investimeve zotëron më shumë se 5 për qind të aksioneve, duhet të miratohet nga shumica e aksionarëve.

- Çdo transaksion ndërmjet fondit të investimeve dhe subjekteve, me të cilat një person i interesuar ka interesa ekonomike, duhet të marrë miratimin paraprak të shumicës së aksionarëve të vetë fondit.

- Personat e interesuar duhet të ruajnë sekretin e të gjitha informacioneve të marra nga shoqëritë, në të cilat ka investuar fondi i investimeve, si dhe të gjithë informacionit jopublik që i përket fondit të investimeve.

XIII. PARIMET E LLOGARITJEVE

Neni 15

15.1. Një fond investimesh do të llogaritë vlerën ekuivalente në kesh për bonot e privatizimit, e cila do të përdoret për të gjitha llogaritjet dhe vlerësimet duke përfshirë:

- Llogaritjen e vlerës neto të aseteve të fondit të investimeve.
- Llogaritjen e numrit të aksioneve në fondin e investimeve, që do të shkëmbehen për çdo bono privatizimi.
- Llogaritjen për vlerësimin e kostos së investimeve të bëra me bono privatizimi.

Vlera ekuivalente në kesh do të llogaritet sipas vlerës së fundit nominale të deklaruar zyrtarisht për këto bono privatizimi.

15.2. Të gjitha fondet e investimeve do të llogaritin vlerën e tyre neto të aseteve në fund të çdo muaji, si dhe ditën e hapjes së nënshkrimit për çdo seri të aksioneve të fondit të investimeve.

XIV. NJOFTIMET

Neni 16

16.1. Fondi i investimeve, jo më vonë se 60 ditë nga përfundimi i çdo periudhe tremujore, do të publikojë në një gazetë të njohur kombëtare dhe do të dorëzojë tek autoriteti rregullues gjendjen financiare, e cila do të përmbajë:

- Një listë të investimeve të fondit që do të përmbajë emetimin, numrin dhe tipin e aksioneve në fund të periudhës tremujore.
- Një listë të transaksioneve të investimeve të kryera gjatë kësaj periudhe.
- Një listë të fitimeve dhe humbjeve kapitale gjatë kësaj periudhe.
- Bilancin pasuror deri në datën e fundit të kësaj periudhe, duke përfshirë një deklaratë për të ardhurat, si dhe gjendjen e vlerës neto të aseteve deri në ditën e fundit të kësaj periudhe.
- Një deklaratë të të gjitha shpenzimeve dhe pagesave të kryera gjatë kësaj periudhe, duke përfshirë edhe pagesat që u janë bërë drejtuesit dhe depozituesit.
- Një deklaratë të të gjitha kontratave ose transaksioneve të arritura dhe të gjitha pagesat e bëra ndërmjet drejtuesit ose çdo dege dhe shoqërie, në të cilat fondi i investimeve ishte në atë kohë investues.
- Identitetin e drejtuesit të tij, depozituesit dhe ekspertit kontabël.
- Identitetin dhe përqindjen e zotëruar nga 10 aksionarët më të mëdhenj të fondit të investimeve.
- Një listë të të gjitha shërbimeve individuale të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, të drejtuesit, depozituesit dhe ekspertit kontabël.

16.2. Fondi i investimeve, brenda 90 ditëve pas përfundimit të çdo viti fiskal të fondit të investimeve, do të publikojë në një gazetë të njohur kombëtare dhe do të dorëzojë tek autoriteti rregullues të njëjtin informacion që është dhënë në fund të çdo periudhe tremujore.

Ky informacion do të shqyrtohet nga ekspertët kontabël të fondit të investimeve dhe do të përfshijë edhe deklaratën e ekspertëve për konstatimet që kanë në lidhje me të.

16.3. Autoriteti rregullues do të ketë të drejtën të shqyrtojë e inspektojë regjistrimet, regjistrat e aksioneve, operacionet e fondit të investimit, drejtuesit dhe depozituesit e tij në çdo kohë dhe pa lajmëruar. Autoriteti rregullues ka të drejtën të thërrasë mbledhjen e

jashtëzakonshme të përgjithshme të aksionarëve të një fondi investimi dhe të ndërmarrë veprime të tjera të konsideruara të nevojshme për të mbrojtur aksionarët e fondit të investimeve, në momentin që autoriteti do të zbulojë parregullsi në operacionin e fondit të investimeve ose shkelje të këtij ligji nga ana e fondit, drejtuesit ose depozituesit të tij.

XV. DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17

Asnjë fond investimesh nuk do të lejohet që nëpërmjet një lajmërimi publik të premtojë të ardhura pozitive për investuesit ose të premtojë se do të riblejë aksionet e fondit të investimeve për çdo çmim të dhënë.

Do të konsiderohet e paligjshme për një fond investimi dhënia ose kryerja e deklaratave të pavërteta me anë të lajmërimeve publike, ose me mënyra të tjera.

Në përputhje me ligjin për shtypin dhe mjete të tjera të masmedias do të konsiderohet e paligjshme për çdo mjet të masmedias, publikimi i çdo lajmërimi që ka të bëjë me një fond investimesh, i cili nuk është shqyrtuar e miratuar më parë nga autoriteti rregullues, ose për të cilin ky miratim është revokuar.

Sanksionet për këto raste do të jenë në përputhje me dispozitat përkatëse të parashikuara në ligjin “Për shoqëritë tregtare”, kreu VII.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1193, datë 11.8.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha